



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Direktorat za Budžet i Finansije

Nr. i Protokollit: 141/34

Procesverbal nga dëgjimi publik për Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba, e mbajtur më 16 shkurt 2024, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti, zyrtarja kryesore financiare Kimete Ukaj, drejtori për Urbanizëm, Mjedis dhe Kadastër, Grejtalb Emini, drejtori për Zhvillim Ekonomik, Katriot Shabani, Inspektorja e Mjedisit, Albulena Emini, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kimete Ukaj: Përshëndetje për të gjithë dhe falemnderit për pjesmarrjen e juaj. Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe teknologji Nr.06-1810 të datës 24.03.2023 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba.

Me këtë rregullore caktohet lartësia e Taksave, Tarifave dhe Gjobave të parapara me këtë Rregullore, që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes, që do t'i paguajnë personat Fizikë ose Juridikë në emër të shërbimeve të kryera, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës Komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve Komunale.

Nga ekzekutivi i kemi vetëm dy propozime, por me këtë diskutim presim mos kemi ndonjë propozim që pastaj ta qesim në kuvend. Të bashkangjitur e keni pasur dokumentin, i kemi dy ndryshime, te neni 8, pika 8.2.5, janë liruar nga taksa edhe Veteranët e UÇK-së dhe familjet e dëshmorëve. Si dhe neni 11, pikat 1.3.3, gjatë periudhës së pushimeve verore, të paguhet

përgjysmë muaji tarifa e pagesës në institucionin parashkollor, pasi deri tash ishte 35 euro, tash paguhet 17.50 euro. Këto ishin dy propozimet nga ekzekutivi, nëse keni ju diqka, çoftë pyetje apo propozim, ne jemi këtu.

Fatmir Hysenaj: Ku e gjetët këtë rregullore, prej 7.30 mëngjes, deri 8.30 mëngjes, nuk guxon mi ra ka ambulanta. A ka naj komunë në Kosovë, që e ka qet rregullore. Për fillim kaq, ma vone e kqyrim.

Grejtalb Emini: Falemnderit të gjithëve që jeni sot në këtë debat publik! Dashta mu ndërlidh me bacin Fatmir, sa i takon trajtimit të bizneseve, sipas ligjit të gjitha bizneset trajtohen njejtë, edhe pse ndoshta në kushte normal nuk është dashur. Ideja se pse janë thirrur edhe gurëthyesit sot, është pikërisht kjo, që në komunën tonë, operojnë mbi 10 gurëthyes mund të them ndër më të mdhenjët në Kosovë dhe prej tyre 50 % janë jashtë Shtimes, veprimtarin e tyre dytësore e zhvillojnë në komunën e Shtimes dhe kërkesa prej shumë qytetarëve kur e sheh rregulloren për taksa dhe gjoba, një biznes, një gurëthyes i cili bënë dëme të jashtzakonshme në infrastrukturë dhe ambient taksohet vetëm 35 euro në vit, si taksë komunale. Këtë vit, ne si komunë, kemi kërkuar mjete financiare prej Ministrisë së Infrastrukturës, 1.2 milion euro, vetëm pér rivitalizim të rrugëve. Rruja që u përmend, dëmtohet nga gurëthyesit që operojnë në pjesën e Reçakut dhe pjesën e Petrovës. Rruja "Anton Çeta", normal që është dëmtu prej gjithë gurëthyesve që operojnë në Komunën e Shtimes, pér shkak të problemeve që kanë egzistuar në tranzit. Ky nuk është fajt juaj. Si komunë, cilat janë përfitimet nga këta gurëthyes që operojnë në Komunën e Shtimes, përvaq që shumica prej punëtorëve që janë të punësuar janë nga rrathi jonë. Mirëpo kapitali financiar i këtyre bizneseve që janë jashtë Komunës së Shtimes, nuk mbetet në komunën tonë, por del diku tjetër. Ne kemi bërë kërkesa të ndryshme, kemi kërkesa edhe nga klubet sportive, fatkeqësi është që një klub sportiv në Shtime, del kërkon mjete financiare te një biznes në Ferizaj, e këtu bizneset që janë gurëthyes në komunën tonë, financojnë klube sportive prej nga e kanë regjistrimin e bizneseve. Këtë kosto, që ne jemi duke e kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës, këtë 1.2 millionshin, kemi mundur t'a investojmë në parqe, ndriqim, por po detyrohem që çdo vjet të rivitalizojmë rrugë. Ky 1.2 milion euro, ja garantoj, që në fshatra, nuk e mbulon as 4 milion euro dëmet që janë në infrastrukturë. Me Policinë e Kosovës e kemi pasur edhe një diskutim, sa i përket infrastrukturës, egziston një betonjerkë në fshatin Dremjak, që e përshkon komplet rrugën, Petrovë, Mollopolc deri në Dremjak, krejt në territor në komunën tonë, e çka përfiton komuna jonë prej asaj betonjerke që është në Dremjak. Unë nuk besoj që, gurëthyesit duhet me pas vetëm një taksë prej 35 eurove, e di që paguani edhe në KPM pér kubik, por këtë pjesë duhet me diskutuar edhe në KPM, këtu mundet me pas propozime pér taksim, kemi kërkesa prej qytetarëve pér taksim, kemi kërkesa prej klubave sportive pér ndihmesë, unë besoj që propozimi mundet me ardhë prej qytetarëve, por unë veq po i them dëmet që neve po na shkaktohen si komunë, komunë në të cilën jetoni edhe shumica prej juve si biznese apo pronarë të bizneseve. Falemnderit!

Albulena Emini: Përhendetje pér të gjithë! Sot është duke u diskutuar një rregullore pér taksa, tarifa dhe gjoba të vitit 2024, në të cilën ne si komunë i kemi të përcaktuara se kush çka ka me pas të përcaktuar me pagu taksën lidhur më zhvillimin e veprimitarive apo edhe të ngjajshme që ka në kuadër të komunës së Shtimes. Si inspektore e mjedisit që jam dhe me punën që e kemi pas me banorë, e në këtë rast disa prej operatorëve i kemi këtu, i kemi pas edhe në takimin para disa ditëve të organizuar nga institucionet relevante që janë kompetent pér veprimitarit e juaja që ushtroni në territor të komunës së Shtimes. Çka po du me thanë me këtë, është që, ne si inspektorat kemi ankesa

Fatmir Hysenaj: Po kush është fajtor që ja u ka dhanë lejet lokaleve, e që tash nuk mujn me qarkullu fmija? Na sun fluturojmë tash që prishet rruga, ju ndoshta nuk e keni shtru asfaltin, por të keqen mos e trashëgoni.

Grejtalb Emini: Me gjithë rrespektin, nuk po flas as për cilësi të asfaltit, por për dëmet që mund të na shkaktohen në fëmijë, është tjetër aspekt që prishet asfalti. Por gjatë intervalit sa është rruga e myllur, mundemi me pas fëmijë, ti mundesh me pas nipa në atë shkollë. Kjo u kanë arsyje bazike pse u bë ky ndryshim.

Lejet ato lokale i kanë moti, ndoshta para lufte dhe atë s'mundemi me ndryshu as ti e as unë sot.

Daut Fazlija: Dua t'i përgjigjем zonjës, para disa ditëve kur mbajtëm mbledhje, ishin ekspertë të fushave dhe parametrat që i kemi ne për zhurëm, i kemi në rregull, se leje ndryshe s'mundemi me marr. Me makinat që i kemi punohet edhe në shtetet tjera, e me to punojmë edhe ne. Për gjobitje unë këta nuk e shoh të arsyeshme.

Albulena Emini: Jam inspektor që disa vite, dhe marr parasysh ankesat e banorëve të fshatit Carralevë dhe Belinc, ne në realitet ju kemi kursyer shume, ju kemi kursyer jashzakonisht shumë prej gjabave, ndoshta jemi detyruar me ardh 10 herë me ju shqiptu vërejtje verbale ndoshta edhe me shkrim, por asnjëherë me ardh me tendencën e gjobitjes. E është fakt që kishim mujt me e basi inspektorat dhe institucion, por as njëherë me tendencë, sepse e dimë që secili prej jush jeni edhe gjenerues të vendeve të punës dhe mbajtës së familjeve të punëtorëve që punojnë të ju.

Edhe ju nganjëherë duhet me dal në pozicionon tonë dhe me e kuptu faktin se qysh është në momentin që ti e nis një ditë pune dhe deri t'a përfundoj, të vijnë ankesat a në mënyrë elektronike a në mënyrë fizike. Dhe e kemi të pamundur, se si me ju shmang një ankesë të banorëve, kur ata edhe bëjnë peticion. Ku kanë thënë se e kanë të pamundur jetën në atë zonë, prej pluhurit, zhurmës dhe makinerive të rënda që operojnë në atë zonë.

Nëse vetëm ndonjëherë e shihni, apo që jeni gjabit me tendence prej inspektoratit të komunës së Shtimes, lirisht përmendeni vlerën, se kur inspektorati ju ka ardhur dhe ju ka gjabit, nëse ti ke qenë çdo gjë në rregull. Sa herë ju kemi inspektu, kërkesa jonë e vetme ka qenë të shtohet sasia e ujites.

Katriot Shabani: Tu e pas parasysh të mirat që ia sillni shtetit dhe njërvë te ju, është pak e rëndë me ardh me ju thënë, që po e bijmë një rregullore, por mos e mendoni që kemi me ju bë dëm juve, por meqenës është një dëgjim publik, është si nisje fillestare, pasi do të shkon në kuvend me u miratu, e pastaj me ardh në një vendim përfundimtar. Nëse jeni të pajtimit me këtë në rregull, por edhe nëse keni naj propzim tjetër se si t'a bëjmë. Esenca e dëgjimit publik është me ju dëgju juve se si është më mirë. Nëse s'ju pëlqen kjo si është, po ju dëgjojmë juve cila është e mira, që të vijmë te një përfundim, pak nga ju, pak nga ne, e t'a nxjerrim një rregullore të mirë. Ose cila prej atyreve që është në rregullore, juve nuk po ju doket e arsyeshme, cili nen, cila takse nuk po ju konvenon, ose është diskriminuese ndaj juve dhe operatorëve që janë.

Daut Fazlija: Për taksë nuk e pata problem se ne paguajme edhe taksa tjera.

Grejtalb Emini: Pavarësisht që kjo rregullore do të shkonë prap në MAPL, pas votimit në kuvend, propozoj që taksat për gurëthyes, betonjerk dhe ekspluatues të zhavorit të jenë nga 1 mij në 20 mij

të vazhdueshme prej banorëve, e në veçanti të Carralevës dhe Belinc. Tash banorët e asaj pjese ku jetojnë, unë nuk e besoj që ja kanë për borxh ndokujt, e aq më pak operatorëve ekonomik ose bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë për interesat të veta, por jo për interesat të qytetarit, çka po du me thanë me këta është që edhe në ditën e takimit që e kemi pas, ka qenë prezent edhe drejtori i Shërbimeve Publike, ka qenë prezent edhe drejtori i Urbanizmit, por edhe inspektorat e përfaqësues prej krimave ekonomike nga Prishtina, kemi ardhur me një përfundim që marrë parasysh, ne si institucion, përkundër dëmeve që i kemi, si në aspektin mjedisor, si në aspektin infrastrukturor, taksa të cilën ju e paguani si operator në kuadër të komunës për ngarkesa, mund të them që është një takse simbolike, përkundër dëmeve që ne si institucion i bartim, por jo vetëm si institucion por edhe si banorë të atyre zonave, po flas konkretisht për zonat Carralevë dhe Belinc, marrë parasysh edhe pjesë tjera që kemi gurëthyes, e që dëmet tash i kemi shumë të mëdha, e për të ardhmen nuk kamë fjalë.

Marrë parasysh, që i keni edhe disa obligime nga institucionet kompetente, ku keni avans të mjeteve për riparimin e tokës, pas përfundimit të operimit, po flas për një periudhe disa vjeçare, prej që unë jamë pjesë e këtij institucioni, nuk e di cili prej operatorëve e ka rehabilituar zonën ku ka operu. Ne kemi pas kërkesa edhe nga qytetarët, që zona ku operojnë gurëthyesit fatkeqësisht, përvëq kafshëve edhe njerëzve mund t'u ndodhë ndonjë aksident.

Edhe në diskutimin e fundit që e kemi pas, marr parasysh që edhe disa komuna tjera e kanë pas po të njejtin propozim, si inspektore e mjedisit, kuptohet me pajtimin edhe të juajin si operatorë që jeni këtu, unë propozoj që ju, në pajtueshmëri kuptohet, ta kemi një bashkëpunim, të vendosjes së një takse që edhe komuna e Shtimes sikur disa komuna të tjera, ta kemi një takse, që ju si operatorë ekonomik që veproni, në kuadër të komunës tonë, ta paguani për dëme të ndryshme, që ne të kemi mundësi mos t'i shfrytëzojmë mjetet apo të hyrat vetanake, për dëmet që realisht shkaktohen nga operatorët-gurëthyesit.

Falemnderit, që keni diçka, lirisht pytni!

Fatmir Hysenaj: Krejt qeto çka po i thoni, janë kështu qysh po i thoni ju. Unë veq po ju them që 43 punënotë punojnë te unë. Rruga që po përmendet, atë e ka shtruar ministria, jo komuna. Ndërsa sa përtaksë, nuk po ankona në taksa, se me 35 euro nuk mbahet komuna.

Nuk mu përgjigje në pytje, ku keni marr yrnek ju, që dy orë në ditë mu ndal rruga, kisha pas qef me ditë prej juve?


Grejtalb Emini: Falemnderit për pyetje! Edhe pse është në kuadër të shërbimeve publike, por me aq sa di unë muj me t'u përgjigj, që të mbes diçka mangut mundesh me fol edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike. E para, ne e dimë të gjithë, se pranë rrugës "William Walker" është shkolla filllore, dhe nga rruga 7:45 deri në ora 8:00 ka qarkullim të jashzakonshëm të fëmijëve. As mu, e as ty për një orë qarkullim nuk bëhet kiameti, se sa me na vdek naj fëmijë aty. Arsyjeja bazike ka qenë kjo. E di që është problematike, sidomos në sektorin e ndërtimit, se shumica prej tyre punojnë nga ora 6:00. Por këtë vit, në kemi planifikuar që të gjitha peshat e rënda, në një vlerë financiare prej 2.5 milion, do të kaloj rruga në fshatin Belinc dhe njëherë e përgjithmonë, do të largohen mjetet e rënda nga rruga në fjalë, e mos t'a kemi këtë problematik as ju, e as qytetarët që jetojnë aty. Nje peshë bartëse, 40 tonë, me kalu rrëth zonave të biznesit, e sidomos rrëth shkollës, ku ka qarkullim të fëmijëve nuk është në rregull dhe ky vendim është marrë në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës.

7.5.2019
euro në vit. Kjo do të bëhet sipas kapaciteteve të prodhimit të gurëthyesve, betonjekrave dhe eksploatuesve të zhavorit. Ne po dojmë që këto taksa, të shkojnë prap në infrastrukturësn e kësaj komune, me pas mundësi ligjore, asnje taksë të gurëthyesve që operojnë në komunën tonë që, që janë nga komuna jonë nuk u'a kishim vendos.

Fatmir Hysenaj: Vetëm të bëhet me të drejtë, se me këto taksa tona çofshin ato edhe 2 mij euro, nuk mbahet komuna.

Grejtalb Emini: Ne mundemi prap me u taku, deri në seancen e radhës së kuvendit, që bashkarisht të gjejmë modalitetin se si me u taksu. 1 mij deri 20 mij është propozim, duhet të ulemi bashkarisht dhe të përcaktojmë kapacitetet e secilit gurëthyes, t'i gjejmë modalitetet në çfardo forme.















Mbledhja ka përfunduar në ora: 15:35



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DEBATIN PUBLIK ME QYTETARË PËR

DRAFT-RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA

Shtime, më 16 shkurt 2024 (e premte)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Sofetin Bushi	Shtimi	
2	Arlen Deliu	Shtimi	
3	SANJE SADIKI	SHTIME	
4	Albana Fazliu	Shtime	
5	Gjergjallë Tërnii	Shtime	
6	BESNIK AHMETI	SHTIME	
7	Vlera Zymoni	Zyma po informim	
8			
9	Shajipe Miftari	Z. Tijone	
10	Gonxhe Osmani	K.K. Shtime	
11	Skënder Dauti	K. Shtime	
12	Daut Fazlija	DP Kastrioti	
13	FATIL HOSANI	fatil.h.hasani	
14	Tiber Rishiti	Maliseti Ptz	
15	FATMIR HJEPEN FU VËHTEZERIT EBRAH.		
16	VALDËT BUGUS EVA	MAKSIT-PJTZ	
17	AJBULENË Gjinini	INSPEKTORAT	
18	Anita Kurbi		